



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 282/3 prot.

Elbasan, me 29.01.2023

VENDIM

Nr. 3 datë 29.01.2023

Për

ulje tarife vjetore të shkollimit të studentëve në Ciklin e dytë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2022-2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së Nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, Bordi i Administrimit me vendim nr 34 datë 04.11.2022 "Për ngritjen e Komisionit "Ad Hoc", Për procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave: Ulje tarife vjetore shkollimi për vitin akademik 2022-2023, të studentëve të Ciklit të dytë të studimeve, për program të parë studimi", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

- 1- Përfitojnë ulje tarife shkollimi 82 studentë me rezultate (mesatare 9-10-të) brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 2- Përfitojnë ulje tarife shkollimi 176 studentë me kriteret e tjera mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Nuk përfitojnë ulje tarife shkollimi 41 studentë, për arsye të mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara, sipas listës bashkëlidhur.
- 4- Ngarkohet komisioni për verifikimin e dokumentacionit (vërtetësinë e tij) dhe stutuseve të studentëve që përfitojnë sipas pikës 2.
- 5- Të evidentohen nga komisioni rastet e studentëve me status të pandryshuar; jetimë, i verbër, tetraplegjikë, paraplegjikë, fëmijë i policit të vrarë, romë egjiptian, të cilët kanë studiuar në ciklin e parë në UE dhe kanë përfituar bursë apo përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, por nuk kanë paraqitur kërkesë deri në periudhën që shqyrtohet, si dhe rastet e paevidentuara të studentëve me rezultate (mesatare 9-10-të), dhe të relatohen në Bordin e Administrimit për përfitim ulje tarife vjetore shkollimi.
- 6- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DÛRMISHI

